

1 E enjte, 7 shkurt 2019

2 Hagë, Holandë

3 Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtetuese

4 [Vendim]

5 [Seancë publike]

6 --- Fillon në orën 12.00 në mesditë

7 FTUESI I GJYQIT: Të gjithë në këmbë. Uluni ju lutem.

8 GJYKATËSJA PAUËR-FORD: Mirëdita.

9 ADMINISTRATORI I ÇËSHTJES: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese
10 të Dhomave të Specializuara të Kosovës kryesuar nga gjykatësja An Pauër-Ford
11 dhe unë, Riaz Haider, Administrator i Çështjes; në Çështjen Mahir Hasani kundër
12 Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Dosja numër KSC-CC-2019-05.

13 GJYKATËSJA PAUËR-FORD: Mirëdita.

14 Hyrje.

15 Kjo është një përmbledhje e vendimit të Dhomës së Specializuar të
16 Gjykatës Kushtetuese mbi kërkesën e zotit Mahir Hasani, më tej Parashtruesi i
17 Kërkesës, për masë të përkohshme në lidhje me urdhrin e Zyrës së Prokurorit të
18 Specializuar të datës 20 dhjetor 2018. Më tej("Urdhri").

19 Publiku është i informuar paraprakisht për datën dhe orën e shqiptimit të
20 vendimit nga Dhoma. Teksti i këtij shqiptimi gjendet në faqen e internetit të
21 Dhomave të Specializuara të Kosovës në tre gjuhët zyrtare të Dhomave të
22 Specializuara të Kosovës.

23 Historiku i shkurtër procedural.

24 Më 15 janar 2019, Parashtruesi i Kërkesës i paraqiti Dhomës së
25 Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, më tej ("Dhoma"), një referim që mban

1 datën 11 janar 2019. Parashtruesi i Kërkesës e paraqiti Referimin në bazë të
2 nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më tej
3 ("Kushtetuta"). Parashtruesi i Kërkesës përfaqësohej nga Dr. Artan Qerkini.

4 Në Referim Parashtruesi i Kërkesës bën ankesë se Urdhri i Zyrës së
5 Prokurorit të Specializuar, që e urdhëron atë të paraqesë dokumente dhe
6 informacione, cenon të drejtën e tij për të heshtur dhe është në kundërshtim me
7 privilegjin e mosinkriminimit të vetvetes dhe prezumimin e pafajësisë.
8 Parashtruesi i Kërkesës mbështetet në nenet 30(6) dhe 31(5) të Kushtetutës dhe
9 në nenin 6(2) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe
10 Lirive Themelore.

11 Parashtruesi i Kërkesës ka bërë kërkesë në bazë të rregullës 21(1) dhe
12 21(2) të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës
13 Kushtetuese, për Urdhër në formën e një mase të përkohshme i cili pezullon
14 Urdhrin deri në marrjen e vendimit nga Dhoma për pranueshmërinë dhe themelësinë
15 e Referimit.

16 Më 15 janar 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, në bazë të nenit
17 33(3) të Ligjit nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit
18 të Specializuar, caktoi një panel të Dhomës Kushtetuese për t'u shprehur në
19 lidhje me Referimin.

20 Më 25 janar 2019, Prokurori i Specializuar paraqiti parashtrimet e tij në
21 përgjigje të Kërkesës për masë të përkohshme të Parashtruesit të Kërkesës.

22 Më 25 dhe 26 janar 2019, Paneli i Dhomës Kushtetuese i përbërë nga
23 gjykatësja An Pauër-Ford, kryetare dhe gjykatësit Vidar Stensland dhe Roland
24 Dekers u mbledh për të kuvenduar.

25 Ky shqiptim lidhet vetëm me vendimin e Dhomës për Kërkesën për masë të

1 përkohshme të Parashtruesit të Kërkesës. Vendimi i Dhomës në lidhje me
2 Referimin do të vijojë më vonë.

3 Historik i shkurtër i fakteve.

4 Më 20 dhjetor 2018, Zyra e Prokurorit të Specializuar i dorëzoi
5 Parashtruesit të Kërkesës dy dokumente, përkatësisht një Fletëthirrje për t'u
6 paraqitur për marrje në pyetje më 11 shkurt 2019, më tej ("Fletëthirrja") dhe
7 Urdhrin për t'i dorëzuar Zyrës së Prokurorit të Specializuar dokumente dhe
8 informacione të caktuara në të njëjtën ditë.

9 Në Urdhër, Zyra e Prokurorit të Specializuar shprehej se Parashtruesi i
10 Kërkesës ishte, hap citimin "i detyruar t'i paraqiste" mbyll citimin, të gjitha
11 dokumentet, të dhënat, shënimet dhe informacionet e specifikuara në Urdhër dhe
12 paralajmërohet se mosparaqitja e dokumenteve hap citimin "do të konsiderohet
13 mosbindje" mbyll citimin, dhe si rezultat i kësaj Zyra e Prokurorit të
14 Specializuar mund të kërkonte nga Dhomat e Specializuara që të merrnin masa që
15 detyrojnë bindjen ndaj Urdhrit.

16 Në Urdhër thuhej gjithashtu se kishte, hap citimin, " arsye për të besuar
17 se Parashtruesi i Kërkesës ishte përfshirë në kryerjen e një krimi brenda
18 juridiksionit të Dhomave të Specializuara të Kosovës", mbyll citimin.

19 Parashtruesi i Kërkesës i ka kërkuar kësaj Dhome që të miratojë masë të
20 përkohshme për pezullimin e Urdhrit që e detyron atë të paraqesë dokumentet, të
21 dhënat, shënimet dhe informacionet e specifikuara në Urdhrin në fjalë.

22 Ligji i zbatueshëm.

23 Dhoma rikujton se në përputhje me rregullin 21(1) të Rregullores së Punës
24 të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Dhoma mund të urdhërojë masë
25 të përkohshme nëse individi përballet, citimi fillon "me rrezik real të dëmit

1 rëndë" mbyll citimin, në rast mosmiratimi të masave të përkohshme.

2 Konstatimet.

3 Në vlerësimin nëse ekziston rrezik real i dëmit të rëndë në rast të
4 mosmiratimit të masave të përkohshme, Dhoma ka mbajtur parasysh parashtrimin e
5 Prokurorit të Specializuar se Parashtruesi i Kërkesës do të informohet më 11
6 shkurt 2019 në lidhje me të drejtën e tij për të heshtur dhe për të mos
7 inkriminuar vetveten dhe Dhoma pranon se ky parashtrim ka njëfarë peshe.

8 Megjithatë, në këtë moment Dhoma e ka të vështirë që të pajtojë këtë
9 parashtrim me kushtet e Urdhrit të Prokurorit që e detyrojnë Parashtruesin e
10 Kërkesës të dorëzojë dokumentet dhe informacionet e specifikuara kur të
11 paraqitet për tu marrë në pyetje më 11 shkurt 2019, moszbatimi i të cilit do të
12 çojë në një konstatim për mosbindje.

13 Dhoma është e mendimit se në pamje të parë Urdhri është problematik për
14 sa i takon kërkesave të drejtësisë sepse përbën një Urdhër për një të dyshuar
15 të konfirmuar që të paraqesë dokumente, të dhëna dhe informacione kur të
16 paraqitet për t'u marrë në pyetje. Nëse do të zbatohet, një Urdhër i tillë mund
17 t'i shkaktojë dëm të rëndë Parashtruesit të Kërkesës nëse statusi i tij do të
18 ndryshojë nga i dyshuar në të akuzuar. Në rast moszbatimi Urdhri paralajmëron
19 se mosparaqitja e dokumenteve, hap citimin "do të konsiderohet mosbindje" mbyll
20 citimin.

21 Sipas kushteve të shprehura të Urdhrit, Parashtruesi i Kërkesës nuk ka
22 zgjedhje tjetër përveçse të zbatojë urdhrat e dhënë në të dhe të paraqesë
23 dokumentet e kërkuara, në qoftë se dëshiron të shmangë konstatimin për
24 mosbindje dhe pasojat që mund të vijojnë prej tij.

25 Mbi bazën e sa më lart dhe duke mbajtur parasysh afatet e kufizuara

1 kohore brenda të cilave bëhet Kërkesa për masë të përkohshme nga Parashtruesi i
2 Kërkesës, Dhoma është e gatshme të pranojë se në rrethanat shumë specifike të
3 këtij rasti ekziston rrezik real i dëmit të rëndë në rast të mosmiratimit të
4 masës së përkohshme.

5 Dhoma konfirmon se ky Urdhër i Dhomës që miraton masën e përkohshme nuk
6 bën gjë tjetër përveçse siguron ruajtjen e statukuosë deri në marrjen e
7 vendimit për Referimin.

8 Dhoma konfirmon se ky Urdhër i Dhomës nuk paragjykon Vendimin në lidhje
9 me Referimin dukë përfshirë edhe çfarëdo konstatimi që mund të bëjë Dhoma në
10 lidhje me pranueshmërinë dhe themelësinë e tij.

11 Dhoma konfirmon gjithashtu se ky urdhër i Dhomës nuk paragjykon
12 detyrimin e Parashtruesit të Kërkesës për t'u paraqitur sipas Fletëthirrjes,
13 për marrje në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar më 11 shkurt 2011.

14 Data e hyrjes në fuqi.

15 Urdhri për masë të përkohshme hyn në fuqi menjëherë.

16 Urdhri.

17 Pas dhënies së kësaj përmbledhje të vendimit të Dhomës dispozitat
18 operative të Urdhrit të saj janë si vijon:

19 Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,
20 *Pezullon* Urdhrin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar të datës 20 dhjetor 2018
21 duke qenë se detyron Parashtruesin e Kërkesës të paraqesë dokumentet, të
22 dhënat, shënimet dhe informacionet e specifikuara në Urdhër, deri kur Dhoma të
23 shprehet për Referimin, ose deri në një urdhër të mëtejshëm.

24 Këtu përfundon shqiptimi i Vendimit të Dhomës.

25 FTUESI I GJYQIT: Të gjithë në këmbë.

1 Pas kësaj, seanca u mbyll në orën 12.09, në mesditë.
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25